



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NDERMARRJA KOMUNALE PLAZH
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. ____ prot.

Durres më, _____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: BLERJE KAMERA SIGURIE

VLERA E FONDIT LIMIT: 1.041.667 (njemilion e dyzet e nje mije e gjashtëqind e gjashtë dhjete e shtate)leke paTvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”,(i ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja Komunale Plazh ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a.** Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- b.** Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: *Argumentimi:* Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-

së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" në të cilin citohet: Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 "Kriteret detyruese për skualifikim" të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, dhe nenit 25 "Kriteret e kualifikimit" të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023,2024 , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Gjithashtu vendosja e kriterëve në reference është bere që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të pershtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tyre në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë dhe menaxhimit të siguri së informacionit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme :

- Certifikatë **ISO 9001:2015** ose ekuivalente “Për sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;
- Certifikatë **ISO 27001:2022** ose ekuivalente mbi “Për menaxhimin e siguri së informacionit” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi :

Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë dhe të sigurisë së informacionit. Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë dhe të sigurisë së informacionit.

Për vet natyrën e objektit të prokurimit është tepër e rendësishme që operatorët si zbatues në funksion të montimit, instalimit, implementimit si dhe konfigurimit të kamerave, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë dhe të sigurisë së informacionit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

ISO 9001 : ose ekuivalent Për sistemet e menaxhimit të cilësisë: është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001: me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Për ky certifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 27001: ose ekuivalent për Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit,

- Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit është i nevojshëm pasi siguron që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përfaqësim sistematik në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria, cila nisur nga rëndësia dhe sensitiviteti i të dhënave që menaxhohen nepermjet sistemit objekt prokurimi, është një element jo vetëm i domosdoshëm por kritik.

Sasia e mallit qe kerkohet siapas tebeles se meposhtme

SASIA E MALLIT

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Kamera sigurie	Cope	50		
	TOTALI PA TVSH				
	TVSH				
	TOTALI ME TVSH				

LËVRIMI I MALLIT

Afati i levrimit, instalimit fizik, konfigurimit dhe testimit perfundimtar te sistemit te kamerave eshte 10 dite nga data e nenshkrimit te kontrates

Mënyrat për llogaritjen e vlerës së prokurimit:

Bazuar në nenin 76 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në përlllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet ti referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) *çmimet e botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe*
- b) *studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
- c) *çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
- ç) *çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

Grupi i Punës, duke marrë në konsideratë rastin në fjalë, natyrën/specifikat e këtij prokurimi, legjislacionin dhe rregullat e tregut për këtë blerje, ka organizuar punën dhe ka ndërmarrë hapa konkret për secilën nga alternativat e përcaktuara në nenin 76 të VKM 285/2021 për llogaritjen e vlerës limit të kontratës (fondit limit), me qëllimin që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. ***Lidhur me këtë proces, grupi i punës pas përgjigjes së INSTAT -it në te cilën shprehen se nuk***

disponojnë listë cmimesh per “Blerje kamera sigurie”nepermjet e-mail zyrtar, ka argumentuar dhe dokumentuar bazuar pikes 1 germa “b” te nenit 76 te ligjit 162/2020 konkretisht:

- ***Sa i përket respektimit të pikës “b”, Grupi i Punës, bazuar në rregullat e tregut, ka kryer studimin e tregut nëpërmjet marrjës së ofertave, për të njohur për aq sa është e mundur, nivelin e tregut aktual. Operatorët Ekonomik të përzgjedhur në mënyrë rastësore për marrjen e ofertave për testimin e tregut, janë subjekte tregtare të liçensuara dhe të regjistruar pranë QKB dhe referuar objektit të veprimtarisë së tyre të publikuara në faqet on-line respektive, por edhe sipas Ekstraktit të Regjistrimit publikuar në faqen zyrtare on-line të QKB, rezultojnë se kanë në objektin e veprimtarisë së tyre, fushen objekt prokurimi.***

SPECIFIKIMET TE KNIKE

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1.Kamera PT me panel diellor

Tipi i kamerës (“Type of camera”)	PT (Panoramic / Tilt)
Procesori i figurës (“Image Sensor”)	Panorama: 1/2.9"CMOS Detail: 1/2.9"CMOS
Rezolucioni i figurës (“Resolution”)	Panorama:3MP,2304×1296@20fps Detail:3MP,2304×1296@20fps
Frekuenca e kuadrove (“Frame Rate”)	deri në 20 fps (“up to 20 fps”)
Tipi i lenteve (“Lens Type”)	Fixed focal lens
Gjatësia fokale (“Local length”)	Panorama: 4mm Detail: 4mm
Ndeshmëria dritës	Color:0.0004lux@(F1.0,AGC ON)
Ndriçimi Infra të Kuqe (“IR illuminators”)	Po; deri në 30 m; (“Yes, up to 30 m”)
Ditë/Natë (“Day/Night”)	Fixed IR-cut
Diapazoni dinamik i dëshëmërisë, (Ëide Dynamic range)	DWDR
Formati i kompresimit të Videos	S+265/H.265
Dedektim i lëvizjes (“Smart Motion Detection”); .	Po (“Yes”) Smart Alarm(human and vehicle detection)Alarm I zgjuar per njerez dhe makina
Alarm për rast sulmi/sabotimi të kameras (“Tampering Alarm”)	Po (“Yes”)
Temperatura e operimit (“Operating Temperature”)	(14°F~122°F) (Charge:-20°C~50°C)
Ushqimi (“Solar Panel”)	DC5V±25%,Max. 10W
Protokollet e rrjetit (“Netëork”)	TCP/IP; UDP; ICMP; DNS; NTP; IPv4; SSH; Unicast
Mikrofon I inkorporuar	1×mikrofon I inkorporuar
Boks I inkorporuar	1×Boks I inkorporuar
Slot per karte memorie	Suporton microSD/microSDHC/microSDXC card,deri ne 256 GB
Alarme per anomali	Disk I mbushur; Gabime te diskut
Metoda e lidhjes	Aktivizim te alarmit; Aktivizim te dritave; Aktivizim te regjistrimit; Aktivizim te fotos
Ndjekje Automatike	Po
Garancia	1 vit

2.Aksesorë montimi për kamer PT

- Te jete per montin ne shtylle
- Te jete modular per instalim te shpejte dhe te thjeshte
- Te jete rezistente ndaj motit
- Te jete per ambiente mjergulle dhe kripra
- Te jete rezistente ndaj vibrimeve sipas standartit

3.Pershkrimi i vendosjes se kamerave te sigurise

Kamerat e sigurise do te vendosen ne zonat me problematike, ku ndodhen koshat e mbeturinave , me qellim monitorimin dhe administrimin me te mire depozitimit te mbetjeve

3.1 Objektivi i Përgjithshëm

Vendosja e sistemit të kamerave synon:

- Parandalimin dhe evidentimin e ndotjes së kundërligjshme
- Identifikimin e subjekteve që hedhin inerte jashtë vendeve të përcaktuara
- Evidentimin e automjeteve përmes monitorimit të targave
- Parandalimin e zjarrvënies në koshat e mbeturinave
- Evidentimin e dëmtuesve të koshave dhe infrastrukturës publike
- Rritjen e disiplinës dhe ndërgjegjësimit qytetar
- Të krijojmë ambiente të sigurta për të gjithë punonjësit që evadojnë mbeturina

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Argumentimi: Specifikimet Teknike të mësipërme janë në përputhje me nenet: Neni 4, pika 38/b të LPP, si dhe nenit 40, pika 2; 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.
Theksojmë se ‘Specifikimet Teknike’ i shërbejnë AK për të patur garanci se malli i ofruar do të jetë në parametrat dhe në cilësinë e duhur.*

Shënim: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike, për procedurën objekt prokurimi janë hartuar nga grupi i punës ngritur me urdher nr 72, date 19.02.2026, miratuar nga titullari i AK, bazuar në parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhenenit 36, të LPP, si dhe nenit 42 dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Përmiratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo dhe çdo standardi të kërkuar.

Te gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.